

emrave, këshillimi me masat etj.

## SHTETËSI

Për shtetësinë shqiptare, *Dekret Nr. 1874, datë 7.6.1954.*

### Neni 1

Janë shtetas të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë:  
a) të gjithë ata që kanë qenë shtetas shqiptarë më datën 29.11.1944  
dhe nuk e kanë humbur më vonë shtetësinë shqiptare;

- b) fëmijët e lindur nga prindër që janë që të dy shtetas shqiptarë;  
c) personat që kanë fituar shtetësinë shqiptare sipas dispozitave ligjore.

#### Neni 2

Në qoftë se prindërit kanë shtetësi të ndryshme, duke qenë njeri prej tyre shtetas shqiptar në kohën e lindjes së fëmijës, dhe kur e pakta njeri prej tyre në kohën e lindjes së fëmijës banon në tokën e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, fëmija është shtetas i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Por në qoftë se njeri prej prindërve është shtetas i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë në kohën e lindjes së fëmijës dhe të dy prindërit banojnë në këtë kohë jashtë tokës së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, shtetësia e fëmijës caktohet me marrëveshje të të dy prindërve.

#### Neni 3

Të huajve, pavarësisht nga kombësia dhe raca e tyre, mund t'u jepet shtetësia shqiptare, mbi kërkesën e tyre, me dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

#### Neni 4

Lidhja e martesës së një shtetasi ose shtetase shqiptare me një shtetas të huaj nuk sjell ndryshim në shtetësi.

#### Neni 5

Lënja e shtetësisë shqiptare mund të bëhet vetëm me leje të Presidiumit të Kuvendit Popullor të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

#### Neni 6

Në rast ndërrimi të shtetësisë nga ana e prindërve, duke u bërë që të dy shtetas shqiptarë, ose duke lënë që të dy shtetësinë shqiptare, ndërron edhe shtetësia e fëmijëve të tyre që nuk kanë mbushur moshën 14 vjeç.

Ndërrimi i shtetësisë së fëmijëve në moshën 14 gjer në 18 vjeç, mund të bëhet vetëm me pëlqimin e tyre.

Në raste të tjera, ndërrimi i shtetësisë shqiptare të shtetasve që

nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç mund të bëhet vetëm sipas rregullit të përgjithshëm.

#### Neni 7

Ndërrimi i shtetësisë së njerit prej prindërve, që janë të dy shtetas shqiptarë dhe që banojnë në tokën e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, nuk sjell asnjë ndryshim në shtetësinë e fëmijës.

Kur njeri nga prindërit, që janë të dy shtetas shqiptarë dhe që banojnë jashtë tokës së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, le shtetësinë shqiptare, shtetësia e fëmijëve të tyre caktohet me marrëveshje të prindërve. Për fëmijët që kanë një moshë prej 14 gjer në 18 vjeç, ndërrimi i shtetësisë bëhet vetëm me pëlqimin e tyre.

#### Neni 8

Heqja e shtetësisë shqiptare bëhet me dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë për çdo rast të veçantë.

#### Neni 9

Personat që banojnë në territorin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, të cilët në bazë të këtij dekreti nuk janë shtetas shqiptarë dhe nuk mund të provojnë shtetësinë e huaj, konsiderohen persona pa shtetësi.

**Për interpretimin e neneve 2 dhe 7 të dekretit Nr. 1874, data 7.6.1954 «Për shtetësinë», Dekret Nr. 3231, datë 20.3.1961.**

Presidiumi i Kuvendit Popullor

u jep dispozitave të neneve 2 dhe 7 të Dekretit Nr. 1874, datë 7.6.1954 «Për shtetësinë» këtë:

#### INTERPRETIM:

Në kuptimin e neneve 2 dhe 7 të Dekretit Nr. 1874, datë 7.6.1954 «Për shtetësinë» nuk quhen se kanë banimin jashtë tokës së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, shtetasit, shqiptarë, që, për arsye studimi ose shërbimi ndodhen në shtete të huaj.